

PULSAR 

PERSPEKTIVA PËR
TË ARDHMEN

**FINCOP &
EDUCOP**

TAKIMI XII I PËRBASHKËT I KP-E dhe KP-KRF

**Konsolidimi i pasqyrave
financiare të sektorit
publik: përfshirja e
njësive të qeverisjes
vendore dhe NSH-ve**

11-13 nëntor 2025,
Vjenë, Austri

CFRR»»

Centre for Financial and
Sustainability Reporting Reform



WORLD BANK GROUP

Qendra për Reformën e Raportimit Financiar (CFRR)
Praktika Globale për Qeverisjen, Banka Botërore

Adresa: Praterstrasse 31, 1020 Vjenë, Austri

Internet: www.worldbank.org/cfr

Postë elektronike: cfr@worldbank.org

Telefon: +43-1-217-0700

PULSAR

Programi për Kontabilitetin dhe Raportimin në Sektorin Publik

Internet: www.pulsarprogram.org

TAKIMI XII I PËRBASHKËT I KOMUNITETEVE TË PRAKTIKËS TË
EDUKIMIT DHE RAPORTIMIT FINANCIAR

Konsolidimi i pasqyrave financiare të sektorit publik: përfshirja e njësive të qeverisjes vendore dhe NSH-ve

11-13 nëntor 2024, Vjenë, Austri

OBJEKTIVAT E SEMINARIT

Objektivat kryesorë të këtij seminari me prani fizike janë:

- Shqyrtimi i zgjidhjeve praktike për konsolidimin e njësive të qeverisjes nën nivelin qendror dhe të ndërmarrjeve shtetërore (NSH) në raportimin e qeverisjes si e tërë
- Diskutimi për zhvillimet më të fundit në SNKSP, përfshirë raportimin e qëndrueshmërisë
- Prezantimi i praktikave të mira ndërkombëtare dhe shkëmbimi i përvojave për kontabilitetin e sektorit publik dhe raportimin e qëndrueshmërisë.

PARATHËNIE

PULSAR, i filluar në vitin 2017, është një program në nivel rajoni dhe vendi me 13 vende përfituese në Evropë dhe Azinë Qendrore. Programi PULSAR 2, që fillon në vitin ushtrimor 2026, ruan strukturën dhe fokusin e programit të parë dhe synon 12 vende përfituese të Evropës dhe Azisë Qendrore. Ky program ka për objektiv nxitjen e ndjekjes dhe fuqizimin e zbatimit të praktikave kontabël, financiare dhe të raportimit të qëndrueshmërisë në sektorin publik, të cilat janë të harmonizuara me standardet ndërkombëtare dhe plotësojnë nevojat e vendeve në kuadër të zhvillimit dhe qëndrueshmërisë.

Objektivat dhe fushëveprimi i Programit PULSAR përcaktohen bashkërisht nga partnerët e Programit PULSAR – Austria, Zvicra dhe Banka Botërore – të cilët japin edhe mbështetjen institucionale për zbatimin dhe mobilizojnë burimet e nevojshme për aktivitetet. Vendet përfituese ndihmojnë në dhënien trajtë Programit PULSAR përmes platformave të

bashkëpunimit rajonal dhe kontributeve në dy komunitetet e praktikës (KP): Komuniteti Praktikës i Raportimit Financiar dhe të Qëndrueshmërisë (KP-RF) dhe Komuniteti i Praktikës i Edukimit (KP-E). Për aspektet e lidhura me ndërmarrjet shtetërore, programi PULSAR do të mbështetet edhe në orientimet e dhëna nga [Komuniteti i Praktikës së Politikëbërësve për NSH-të](#) në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Partneritetit Lindor, të ngritur së fundmi.

Kontabiliteti në sektorin publik (KSP) dhe raportimi i qëndrueshmërisë janë jetike për promovimin e qeverisjes së përgjegjshme, nxitjen e transparencës dhe garantimin që njësitë ekonomike publike të kontribuojnë pozitivisht për shoqërinë dhe për mjedisin. Shumica e qeverive e përdorin në mënyrë të kufizuar informacionin kontabël në vendimmarrjen për politikën dhe administrimin, përfshirë edhe realizimin efektiv të shërbimeve. Qeveritë në të gjithë EAQ-në sistematikisht i nëndeklarojnë aktivet. Qeveritë hasin në vështirësi sa i takon analizimit të detyrimeve të kushtëzuara, në funksion të garantimit të qëndrueshmërisë afatgjatë. Shumica e vendeve të EAQ-së hasin vështirësi në hartimin e pasqyrave financiare të konsoliduara.

Qeveritë qendrore përballen me sfida të konsiderueshme në konsolidimin e pasqyrave financiare të njësive të qeverisjes nën nivelin qendror, pasi këto hartohen sipas kornizave të ndryshme kontabël. Në shumë vende, sistemet e informacionit të drejtimit nuk janë funksionale ose njësitë e qeverisjes vendore nuk kanë të drejta hyrjeje në SIMF. Kjo e ndërlikon më tej sigurimin e njëtrajtshmërisë dhe krahasueshmërisë së të dhënave për konsolidimin. Konsolidimi i informacioneve të NSH-ve në pasqyrat e qeverisjes si e tërë has në sfida të ngjashme. NSH-të luajnë rol jetik në ekonomi dhe shoqëri, si të rëndësishme që janë për ofrimin e shërbimeve publike thelbësore, zhvillimin e infrastrukturës dhe krijimin e vendeve të punës. Konsolidimi i NSH-ve mund të jetë sidomos kompleks, për shkak të strukturës së veçantë, objektivave të dyfishtë: publikë dhe tregtarë, dhe marrëdhënies me qeveritë dhe tregjet.

Njëherazi, po rritet roli i raportimit të qëndrueshmërisë në sektorin privat, si edhe në atë publik, me përfshirjen në kontabilitet të aspekteve mjedisore, shoqërore dhe qeverisëse. Në përgjigje të kësaj kërkesë në rritje të shpejtë, Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (BSNKSP) planifikon të publikojë standardin e parë të raportimit të qëndrueshmërisë (SRQ) për sektorin publik brenda fundit të këtij viti. Në këtë kuadër, nëpunësit shtetërorë duhet të informohen dhe të fillojnë përgatitjet për zbatimin e praktikave të raportimit të qëndrueshmërisë në vendet përkatëse.

Ngritja e kapaciteteve profesionale përbën një element me rëndësi kritike për fuqizimin e kontabilitetit të sektorit publik dhe për të siguruar që fondet publike të administrohen në mënyrë efektive, efikase dhe etike. Disa vende të PULSAR-it kanë filluar punën për kualifikimin profesional.

Shënime:

- Orari i seancave është sipas orës lokale të Vjenës
- Me përkthim simultan në gjuhët shqipe, serbe/kroate/boshnjake dhe ruse.

PROGRAMI | DITA E MBËRRITJES | E HËNË, 10 NËNTOR 2025

19:00 – 21:00 Pritje

PROGRAMI | DITA 1 | E MARTË, 11 NËNTOR 2025

08:30 Regjistrimi, kafeja e mirëseardhjes

Prezantimi i ditës

09:00

Fjala e hapjes

Adrian Fozzard | Menaxher Praktike, Institucionet, Banka Botërore

Arman Vatyan | Drejtues Ekipi, PULSAR, Banka Botërore

Përse ka rëndësi konsolidimi

Në këtë seancë identifikohen përfitimet dhe rëndësia që ka konsolidimi i pasqyrave financiare për të përfshirë njësitë e qeverisjes nën nivelin qendror dhe NSH-të, nga perspektiva e besueshmërisë së informacionit financiar, vendimmarrjes dhe nga perspektiva makro-buxhetore, dhe në të prezantohen kompromiset dhe sfidat me të cilat do të përballen politikëbërësit gjatë punës për një konsolidim më të fortë.

09:15

Thomas Müller-Marqués Berger | MMB Consult, kontabilist i miratuar dhe këshilltar fiskal gjerman, ish-ortak auditimi në EY dhe udhëheqës global për kontabilitetin ndërkombëtar në sektorin publik, Ish-Kryetar i Grupit Konsultativ të BSNKSK-së

Ross Smith | Drejtor programi dhe drejtor teknik, BSNKSP

Iain Murray | Drejtor, Menaxhimi i financave publike, CIPFA

Bernhard Schatz | Menaxher i Lartë, PwC, dhe ish-anëtar në BSNKSP

Guido Viik | Këshilltar, Drejtorja për Politika të Informacionit dhe Inteligjencës Financiare, Ministria e Financave, Estoni

Drejtues:

Arman Vatyan | Drejtues Ekipi, PULSAR, Banka Botërore

10:45

Fotografi në grup dhe pushim për biseda

Konsolidimi i NSH-ve – aspekte praktike dhe arritja e një drejtpeshimi

Diskutohet për veçantitë e konsolidimit të NSH-ve me pasqyrat financiare të qeverisjes si e tërë.

11:15

Immanuel Frank Steinhilper | Specialist i lartë për qeverisjen dhe Udhëheqës i programit global për NSH-të, Banka Botërore

Thomas Müller-Marqués Berger | MMB Consult, kontabilist i miratuar dhe këshilltar fiskal gjerman, ish-ortak auditimi në EY dhe udhëheqës global për kontabilitetin ndërkombëtar në sektorin publik, Ish-Kryetar i Grupit Konsultativ të BSNKSP-së

Bernhard Schatz | Menaxher i Lartë, PwC, dhe ish-anëtar në BSNKSP

Drejtues:

Peter Farup Ladegaard | Specialist i lartë për qeverisjen, Banka Botërore

12:30

Dreka

Agregimi në dallim nga konsolidimi i raportimit buxhetor dhe i pasqyrave financiare - harmonizimi i mekanizmave të ndryshëm të raportimit

Në këtë seancë shihen praktikat aktuale raportuese të njërive të qeverisjes në nivelin qendror dhe NSH-ve për raportimin buxhetor dhe financiar dhe se si bëhet konsolidimi ose agregimi i këtyre raporteve në praktikë për të parë harmonizimin e tyre me kërkesat e SNKSP-ve për një transparencë dhe vendimmarrje më të mirë.

13:45

Iain Murray | Drejtor, Menaxhimi i financave publike, CIPFA

Manj Kalar | ekspert për SNKSP-të

Guido Viik | Këshilltar, Drejtoria për Politika të Informacionit dhe Inteligjencës Financiare, Ministria e Financave, Estoni

Drejtues:

José Rezk | Specialist i lartë për menaxhimin financiar, Banka Botërore

15:00

Pushim për kafe dhe biseda

Programet e asistencën teknike në nivel vendi

Prezantimi i programeve të planifikuara dhe të filluara të asistencës teknike në nivel vendi dhe të rehat më të fundit mbi kornizat e vlerësimit PULSE dhe vlerësimet e kryera së fundmi, përfshirë aktivitetet për të arritur konsolidimin dhe hartimin e pasqyrave financiare të qeverisjes si e tërë.

15:30

Nysret Koca | Drejtor i Përgjithshëm në detyrë, Thesari i Shtetit, Ministria e Financave, Kosovë

Minas Trubljanin | Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria për Zhvillimin e Harmonizimit Qendror të Kontrollit të Brendshëm, Ministria e Financave, Mali i Zi

Karen Alaverdyan | Drejtor i Drejtorisë së Metodikës së Kontabilitetit të Sektorit Publik dhe Monitorim-Raportimit, Ministria e Financave, Armeni

Dmitri Gourfinkel | Specialist i lartë për qeverisjen, Banka Botërore

Drejtues:

Arman Vatyán | Bashkëdrejtues Ekipi, PULSAR, Banka Botërore

17:00

Mbyllja e ditës 1

PROGRAMI | DITA 2 | E MËRKURË, 12 NËNTOR 2025

Analizim i kontekstit – kornizat kontabël në njësitë e qeverisjes nën nivelin qendror

Prezantohen kornizat kontabël aktuale të përdorura nga njësitë e qeverisjes vendore në vende të ndryshme, për të identifikuar sfidat dhe mundësitë për harmonizim. Biseda përqendrohet te rreziqet (detyrimet) buxhetore dhe mundësitë (administrimi efektiv i aktiveve dhe gjenerim i të ardhurave).

09:00

Andreas Bergmann | profesor i financave publike dhe Drejtor për Sektorin Publik pranë Universitetit të Shkencave të Aplikuara të Zyrihut (ZHAW)

Ross Smith | Drejtor programi dhe drejtor teknik, BSNKSP

Lyudmila Haponenko | Drejtoreshë, Drejtoria për Politikën Kontabël, Ministria e Financave, Ukrainë

Andi Memeti | Zëvendësministër, Ministria e Financave, Shqipëria

Drejtues:

Arun Manuja | Bashkëdrejtues Ekipi, PULSAR, Banka Botërore

10:30 Pushim për kafe dhe biseda

Teknikat dhe instrumentet e konsolidimit

Ekspertët prezantojnë instrumente dhe teknika praktike për konsolidimin e të dhënave financiare në njësi ekonomike të ndryshme, përfshirë edhe nëpërmjet *data warehouse* ose *data lake* në SIMF.

- 11:00** **Khuram Farooq** | Specialist i lartë për qeverisjen, Banka Botërore
- Sangwook (Paul) Nam** | Drejtor i Divizionit të Operacioneve të Sistemit të Shlyerjeve DBrain+, KFIS, Kore
- Hans Hartmann** | Ortak, PWC Austria
- Iwona Warzecha** | Specialist i Menaxhimit Financiar, Banka Botërore
- Drejtues:
- Fabian Seiderer** | Menaxher Praktike, Institucionet, EAQ Perëndim, Banka Botërore

12:30 Dreka

Të reja mbi SNKSP-të, SEKSP-të dhe programin PULSAR

Kjo seancë do të përqendrohet te progresi në SNKSP-të, përfshirë standardin për raportimin e qëndrueshmërisë, dhe në projektin e Standardeve Evropiane të Kontabilitetit të Sektorit Publik dhe strategjitë e përdorura për nxitjen e përdorimit të standardeve. Do të prezantohet dokumenti i Raportimit të Qëndrueshmërisë i publikuar së fundmi nga PULSAR/KIPF.

- 13:45** **Ross Smith** | Drejtor programi dhe drejtor teknik, BSNKSP
- Peeter Leetmaa** | Udhëheqësi i ekipit të SEKSP, Eurostat [online]
- Dmitri Gourfinkel** | Specialist i lartë për qeverisjen, Banka Botërore
- Sung-Jin Park** | As. Profesor, Departamenti i Administratës Publike Globale, Universiteti Yonsei, Kore [online]
- Drejtues:
- Arman Vatyán** | Drejtues Ekipi, PULSAR, Banka Botërore

15:00 Pushim për kafe dhe biseda

Seanca 1 KP-E: Përfshirja e temave të agregimit dhe konsolidimit në programet mësimore universitare dhe në programet e formimit profesional

15:30

Në këtë seancë do të shihen strategjitë dhe shembuj praktikë për përfshirjen e konsolidimit të pasqyrave financiare të sektorit publik (përfshirë njësitë e qeverisjes në nivelin qendror dhe NSH-të) në programet e kontabilitetit në nivel universitar dhe në kurset e formimit profesional të ofruara nga OPK-të

Iain Murray | Drejtor, Menaxhimi i financave publike, CIPFA

Giuseppe Grossi | studiues/profesor kërkimor i Kontabilitetit pranë Universitetit “Nord” (Norvegji); profesor i menaxhimit dhe kontabilitetit publik pranë Universitetit “Kristianstad” (Suedi)

Giovanna Dabbicco | PhD, studiuese e lartë në Institutin Kombëtar të Statistikave (ISTAT), Itali

Natalia Konovalenko | Konsulente për menaxhimin financiar, Banka Botërore
Drejtues:

José Rezk | Specialist i lartë për menaxhimin financiar, Banka Botërore

19:00

Darkë në grup

21:00

Mbyllja e ditës 2

PROGRAMI | DITA 3 | E ENJTE, 13 NËNTOR 2025

09:00

Seanca 2 KP-E: Çuarja përpara e arsimit & ngritjes së kapaciteteve për kontabilitetin e sektorit publik

Kjo seancë do të përqendrohet në sfidat dhe mundësitë aktuale për arsimin në KSP, instrumentet dhe teknikat e reja që ndihmojnë në procesin e mësimdhënies; përfshirjen e temave të reja si raportimi i qëndrueshmërisë dhe IA në procesin e mësimdhënies, si dhe në diskutimin e strategjive për zhvillim të vazhdueshëm profesional për kontabilistët në sektorin publik.

Paolo Fedele | as. profesor për kontabilitet & administrim, Universiteti i Udines, Itali

Sandra Cohen | profesoreshë për kontabilitet, Universiteti i Ekonomisë dhe Biznesit i Athinës, Greqi

George Hertbert | Drejtor, ACCA Consultants

Drejtues: **José Rezk** | Specialist i lartë për menaxhimin financiar, Banka Botërore

Natalia Konovalenko | Konsulente për menaxhimin financiar, Banka Botërore

10:30 Pushim për kafe dhe biseda

Kafeneja botërore - praktikat e konsolidimit

Diskutim për prioritetet e reformave, sfidat e zbatimit dhe përvojat në lidhje me praktikat e konsolidimit të njësive të qeverisjes në nivelin qendror dhe NSH-ve. Raportimi nga vendi mbi mësimet kryesore të nxjerra.

Drejtues:

11:00

Andreas Bergmann | profesor i financave publike dhe Drejtor për Sektorin Publik pranë Universitetit të Shkencave të Aplikuara të Zyrihut (ZHAW)

Khuram Farooq | Specialist i lartë për qeverisjen, Banka Botërore

Sangwook (Paul) Nam | Drejtor i Divizionit të Operacioneve të Sistemit të Shlyerjeve DBrain+, KFIS

José Rezk | Specialist i lartë për menaxhimin financiar, Banka Botërore

Natalia Konovalenko | Anëtare e ekipit për KPE-në, Banka Botërore

Garik Sergeyan | Specialist i lartë për menaxhimin financiar, Banka Botërore

Diskutim për planin e punës të PULSAR 2: Hapat në vijim

Diskutim për planin e punës të programi PULSAR 2, hapat në vijim, përfshirë veprimtaritë e reja në nivel vendi, datat dhe temat për konferencën e ardhshme dhe produktet e dijeve, përfshirë edhe mbulimin e konsolidimit të NSH-ve dhe njësive të qeverisjes vendore gjatë këtij aktiviteti.

12:00

Arman Vatyan | Drejtues Ekipi, PULSAR, Banka Botërore

Arun Manuja | Bashkëdrejtues Ekipi, PULSAR, Banka Botërore

José Rezk | Specialist i lartë për menaxhimin financiar, Banka Botërore

Mbyllja e seminarit

Fjala mbyllëse

12:50

Fabian Seiderer | Menaxher Praktike, Institucionet, EAQ Perëndim, Banka Botërore

Arun Manuja | Bashkëdrejtues Ekipi, PULSAR, Banka Botërore


13:00 Dreka

14:30 Fundi i seminarit

PROGRAMI PULSAR

MENAXHOHET NGA

BASHKËFINANCOHET NGA



Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,
Education and Research EAER
State Secretariat for Economic Affairs SECO